

URDHËR

Nr. 33, Datë 16/03/2016

DISA MASA

**PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET
DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 39 (Rektori), nenin 131, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit nr. 110, datë 15.03.2016, të MAS, "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHEROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, **në datën 16.03.2016;**
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, është **data 20.04.2016;**
3. Senati Akademik, **brenda datës 19.03.2016**, zgjedh me votim të fshehtë, anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), me përfaqësues nga çdo fakultet dhe studentët. Senati cakton edhe sekretarin e KIZ, i cili është anëtar pa të drejtë vote pranë KIZ. Dekanët e fakulteteve, brenda afateve të përcaktuara, të organizojnë punën në zbatim të pikës 1, nenit 6, të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për të sensibilizuar personelin akademik;





4. Në zbatim të nenit 11 (Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", DMBNJ pranë rektoratit të UART në bashkëpunim me departamentet pranë fakulteteve, të hartojnë listat e zgjedhjeve për personelin akademik, të punësuar me kohë të plotë, **brenda datës 31.03.2016;** Sekretaritetë mësimore, pranë fakulteteve, të hartojnë listën e zgjedhësve për studentët, **brenda datës 25.03.2016;**

5. Emrat kandidatë për anëtar të KIZ, që do të zgjidhen nga Senati Akademik, nuk duhet të jenë nga anëtarët e personelit akademik ose student, që do të vetëkandidohen për autoritetet drejtuese ose në organet drejtuese në UART;

6. Në zbatim të pikës 1, 2, të nenit 39, (Ankimi në Komisionin e Apelit), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik, **brenda datës 19.03.2016,** publikon kërkesën për aplikim për anëtar në Komisionin e Apelit;

7. Kancelari i UART të vendosë në dispozicion të komisioneve të zgjedhjeve dhe Komisionit të apelit ambientet dhe bazën materiale të nevojshme për mirëfunksionimin e gjithë procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në UART.

8. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit të zgjedhjeve të ruhet në bazë të rregullave në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arshivimin e dokumentacionit;

9. Ngarkohen në zbatimin e këtij urdhri, i gjithë personeli akademik, studentët, punonjësit e administratës, autoritetet drejtuese në UART;

10. Ky urdhër, të shpallet në të tre fakultetet dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


Prof. Petrit MALAJ
REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE